

L.M.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka depozituar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kërkesën për procedim disiplinor me masën “*Ulja e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit*”, ndaj magjistratit L.M., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier më 21.10.2022.

KLP pezulloi procedimin disiplinor me arsyetimin se subjekti i procedimit ishte në proces rivlerësimi kalimtar.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen plenare të dt.10.12.2024 me vendimin nr.261, ka vendosur përfundimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistratit L.M., pa një vendim përfundimtar. (L.M. kishte humbur statusin për shkak të largimit nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, më 26.10.2024)